



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura V**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Mbledhja nr. 14/2015

Prishtinë, më 7.4.2015, në orën 09:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,**  
**TREGTI DHE INDUSTRI**

**Në mbledhje morën pjesë:** Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Blerim Grainca, Enver Hoti dhe Duda Balje - anëtarë.

**Munguan:** Sasha Milosavleviq, Fatmir Rexhepi dhe Pal Lekaj - anëtarë.

**Pjesëmarrës të ftuar:** Merita Kostari, Krenar Bujupi dhe Rifat Blakaj - Zyra e Rregullatorit për Energji.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Lumnije Murati- ZPRK; Ymer Fejzullahu –ZRRE; Lejla Selimi-OSBE; Dardan Abazi – INDEP; Sylejman Blaku - Kosova- Sot; Pranvera Musa – Kosova- Press; Besa Berisha, Arta Xhyllani dhe Blendina Krasniqi – UNDP (praktikante).

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

**Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.**

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 01.04.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE për vitin 2014;
4. Të ndryshme.

*Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 01.4.2015**

*Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 01.4.2015 u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE për vitin 2014**

**Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa-** Tha se për sot kemi të ftuar përfaqësuesit e ZRRE-së për të prezantuar Raportin vjetor të ZRRE-së dhe për t'u përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Ai shtoi se të pranishëm nga ZRRE-ja janë znj. Merita Kostari, z. Krenar Bujupi, z. Rifat Blakaj dhe z. Ymer Fejzullahu. Fjalën ia dha znj. Kostari të fillojë me prezantimin e raportit.

**Merita Kostari (ZRRE),** fillimisht sqaroi se raporti i cili është dorzuar është për vitin 2014, ndërsa shtoi se vitin e kaluar nuk janë takuar me Komisionin. Më tutje ajo potencoi se raporti është ndryshuar në aspektin pozitiv, krahasuar edhe me vitin e kaluar edhe me vitet paraprake. Ky raport ka një përmbajtje e cila është përcaktuar në një takim të mbajtur më 15 shkurt dhe forma e saj, përmbajtja e këtij raporti është e ndarë kryesisht në ato aspekte të cilat zyra e rregullatorit bazuar në ligjin e rregullatorit vepron. Në vazhdim ajo prezantoi raportin duke thënë se kapitulli i parë i këtij raporti paraqet strukturën organizative të ZRRE-së me përshkrimin e aktivitetit të bordit dhe përshkrimin e departamenteve, si dhe të njësis së administratës, gjithashtu kjo pjesë përfshin edhe projektet e asistencës teknike, ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimet profesionale të stafit të ZRRE-së, mandej në vazhdim është paraqitur procesi i monitorimit të cilin e zbaton ZRRE-ja, bazuar në ligjin e rregullatorit të Energjisë. Kjo pjesë e raportit të monitorimit është e përfshirë në një mënyrë të përgjithshme bazuar në faktet se raporti i veçantë i monitorimit të cilën e përgaditë zyra e rregullatorit për energji është një raport shumë volominoz dhe ai është gati të përfundojë brenda prillit, dhe sa kemi numruar deri më tash është 106 faqe, përmban të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e ZRRE-së, do të thotë me veprimtarinë e kompanive të licencuara. Në kapitullin e gjashtë të raportit ajo tha se është përfshirë analiza komplete e sektorit të energjisë elektrike dhe njëkohësisht janë dhënë vlersimet mbi natyrën se si është menagjuar situata energjetike gjatë gjithë vitit 2014. Më tutje ajo potencoi se në këtë pjesë përfshihet gjendja dhe karakteristikat e rrjetit të transmissioinit, shpërndarjes, të prodhimit, rrjedhjeve të energjisë elektrike, konsumi i përgjithshëm, ngarkesat, humbjet, furnizimi i importit dhe eksportit, si dhe faturimi dhe arkëtimi i raportit. Kapitulli i shtatë trajton tarifat e energjisë elektrike me përshkrim të bazës ligjore, është përshkruar procedura për shqyrtimin tarifor të jashtëzakonshëm, me theks të veçantë analizen e procesit tarifor gjatë vitit rregullativ dhe vitit kalendarik të raportuar gjatë vitit 2014. Kapitulli i tetë flet për sektorin e ngrohjes, sqaroi znj. Kostari, ky kapitull përmban informata rreth karakteristikave, performances së ngrohjes qendrore, të konsumit të lëndës djegëse dhe çmimeve, furnizimit dhe humbjeve në sistem. Sektori i gazit natyror është paraqitur në kapitullin e nëntë, siç e dimë të gjithë ne nuk kemi gaz natyror, mirëpo kemi obligim të përcjellim të gjitha rrjedhat dhe aktivitetet që ndodhin në rajon në lidhje me gazin natyror. Kapitulli i dhjetë shpjegon aktivitetin e ZRRE-së lidhur me mbrojtjen e konsumatorëve, ku znj. Kostari potencoi se kësaj çështje ZRRE-ja i kushton shumë rëndësi, rëndësi të veçantë, e posaqerisht zgjidhjeve të ankesave dhe kontesteve nga konsumatorët dhe të licencuarit. Po në këtë pjesë ajo tha se trajtohet edhe përfaqësimi ligjor lidhur me rastet e kontestëve që janë subjekt i shqyrtimëve gjyqësore. Kapitulli i dymbëdhjetë paraqet raportin financiar dhe ka përfshirë të hyrat, buxhetin dhe shpenzimet buxhetore për dallim nga viti i kaluar edhe vitet paraprake ky kapitull përmban edhe raportin e auditorit të detajuar financiar për vitin paraprakë. Gjatë vitit 2014-të Bordi i ZRRE-së ka mbajtur 11-të seanca të rregullta dhe 1 seancë të jashtëzakonshme gjatë të cilave seanca Bordi ka nxjerrë 95

vendime për çështje të ndryshme. Ajo potencoi se përveç seancave të rregullta dhe të jashtëzakonshme Bordi ka zhvilluar edhe shumë takime informuese dhe konsultative çdo herë që ka qenë e nevojshme. Të gjitha vendimet që janë nxjerrë nga ZRRE-ja janë të publikuar në web-faqën në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, sqaroi në fund znj. Kostari.

**Kryetari Muhamet Mustafa** - Tha se është një raport mjaft voluminoz, jep shumë të dhëna dhe informata të dobishme, e përcjell metodologjinë e caktuar dhe obligimet ligjore d.m.th. në këtë drejtim struktura iu përgjigjet atyre obligimëve. Raporti e përshkruan gjendjen e obligimëve që ka realizuar ZRRE-ja, por nuk janë paraqitur shumë vështirësitë që janë paraqitur në furnizimin, sa i përket vëllimit dhe sa i përket standardeve, vështirësitë nga aspekti i zbatimit të ligjit ose në aspektin teknik, po ashtu në raport përshkruhet incidenti natyrisht nuk është roli i rregullatorit që me gjetur fajtorin e atij incidenti, plasjes së kazanit, por megjithatë është një problem që është cekur, por nuk kemi pasur shumë problem të tjera. Më tutje z. Mustafa potencoi se aktiviteti i bordit nuk është përshkruar aq sa duhet, më tepër në detaje është përshkruar aktiviteti ndërkombëtar, por nuk e kemi parë një strukturë të mbledhjeve, çështjeve në të cilat është preokupuar bordi gjatë vitit të kaluar, në cilat çështje kanë qenë të përqendruar d.m.th. janë trajtuar, nuk kam mundur ta gjej. Aktiviteti investues i operatorëve është jashtëzakonisht i rëndësishëm, këtu janë prezantu, por janë të përshkrume në aspektin fizik, tha z.Mustafa, dhe parashtoi disa pyetje konkrete, KOSTI çka ka investuar? KEDS-i çka ka investuar? Sa ka investuar KOST-i? Sa ka investuar KEDS-i? Sa është plani i investimeve? A është përmbushur ai plan investiv? A kemi ngecje në atë plan të investimëve? Në vijim kryetari Mustafa vlerësoi se ndarja e KEK-ut nga KEDS-i është realizuar me një sukses të konsiderueshëm dhe tash kemi një operator të shpërndarjes të pavarur, por këtu nuk kemi një informatë, ne kemi pasur një kontest midis KEK-ut dhe KEDS-it lidhur më 17 e diçka milionë apo 19 milionë euro, çka ka ndodhur? KEK-u është dashur me paguar, por ka ekzistuar një kontest, për këto që kanë ndodhur kërkoi të jipene informacione. Është një rrethanë pozitive, një trend i zvogëlimit të humbjeve teknike dhe komerciale, shihet që kemi një arkëtim shumë të mirë në krahasim me faturimin dhe një trend pozitiv këtu d.m.th. 94-95% edhe më shumë përqindje të faturave tash KEDS-i po i mbledh, përpara KEK-u s'ka mundur me i mbledh por KEDS-i po i mbledh tani. Na kanë mbetur humbjet komerciale dikun 20 e diçka % , 23 -24 %, dhe këtu kemi 4 % d.m.th. kemi 20 % humbje, ku po na ndodhin? Ku janë ato humbje? Po supozojmë që janë në pjesët e Kosovës të banuar me minoritete kryesisht apo jo, dëshirojmë të dimë konkretisht sepse konsumatorët që paguajn, 94 % të konsumatorëve ngarkohën me çmim edhe për një pjesë të humbjeve komerciale të cilat janë pa fajin e tyre kjo është një çështje që e kemi trajtuar edhe në komisionin hetues, çfarë është kjo qështje kur shteti nuk është i aftë, operatorët nuk janë të afët atëherë pse të paguajnë qytetarët në vend të atyre që nuk paguajnë? Më tutje kryetari Mustafa tha se këtë çështje e kemi shtruar në komisionin hetues që ka mbetur pa u zgjidhur dhe kërkoi që rregullatori ta ketë parasysh. Çështja tjetër është raporti me konsumatorët që shihet se janë trajtuar me një efikasitet këto ankesa, mirëpo nuk kemi kurrfarë raportimi me këtë problemin e orëve dhe problemet që janë ndalur me cilësinë e matësve, orë matësve, njehësorve dhe ato janë çështje që kanë të bejnë me standardin e furnizimit. Ai potencoi se rregullatori nuk mund t'i ikë asaj duhet të ketë një informatë të sakët, sepse konsumatorët kanë pasur vërejtje dhe mu për këtë është edhe problem i investimeve, nuk po i shohim ato investime, si është situata me çështjen e këtyre njehësorëve? Këto ishin disa çështje për të cilat z.Mustafa kërkoi të ketë një informatë më të hollësishme nga raportimi i ZRRE-së.

**Visar Ymeri**- Tha se kam disa çështje që lidhen me raportin dhe i paraqiti në vazhdim. Në kapitullin 1.7 të burimet e financimit tha se këtu e kam bërë një krahasim me raportin e vitit 2013 ku në vitin 2013 siç e keni raportuar thuhet që keni pasur prej 33 pozitave, 27 të punësuar, kurse në vitin 2014 nga 33 pozita 24 janë të punësuar që do të thotë minus 3 të punësuar, ndërkohë që në raportin e vitit 2013, po ashtu e keni përmendur se kjo është një problem, mungesa e stafit në përgjithësi gjë që ju ka penguar që ta kryeni punën siç duhet ndërkohë që në raportin e vitit 2014

nuk ka informata as nga kush janë paguar dhe sa ka paraqitur problem kjo në realizimin e punëve, çka ka ndryshuar në këtë drejtim që ZRRE-ja të mos e raportoj këtë si çështje? Te kapitulli ku flitet për kapacitetet e reja gjeneruese, këtu u përmendet që ZRRE-ja ka qenë e përfshirë në komisionin për tenderim. Mirëpo ka informata të pamjaftueshme për atë se si ka rrjedh ky tender, ne e dimë se çka është raportuar nëpër media, që vetëm një kompani që ka ofertuar e cila në një farë mënyre është shpallur si fituese e tenderit. Pra mendoj që në raport është dashur të përfshihen më tepër informata me atë se si ka rrjedhur ky procesi i tenderimit? A ka qenë oferta në përputhje me kushtet e tenderimit? Një çështje tjetër që më ka tërhequr vëmendjen këtu është që njëri prej faktorëve që raportohet si pengesë për liberalizimin e tregut këtu është mungesa e fleksibilitetit të kapaciteteve gjeneruese, ndërkohë që me ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re thoni se do të rritet fleksibiliteti! Unë nuk e kuptoj si do të rritet fleksibiliteti lidhur me këtë kur e dimë që ky tremocentral do t'i ketë siç është paramenduar dy blloqe nga 300 megavat dhe kjo nuk është që e rrit fleksibilitetin e këtyre kapaciteteve gjeneruese karshi pengesave të tregut. Lidhur me humbjet ai tha se në raport thoni që humbjet në sistemin e shpërndarjes mbetën të larta, ndërkohë nuk i krahasoni se me çka mbetën të larta krahasuar me vitin e kaluar, krahasuar me planin për reduktimin e tyre e kështu me radhë. Në raport flitet poashtu edhe për investimet që janë bërë nga operatori i shpërndarjes dhe furnizimit. KEDS- apo KOST siç e pat emrin dhe nuk tregohet se cilat kanë qenë shumat e investuara d.m.th. sa janë ato 7 apo 8 linja të investimit dhe çfarë ndikimi kanë pasur këto në reduktimin e humbjeve, sepse nga raporti vërehej se sa i përket humbjeve teknike nuk është se ka pasur ndonjë përparim, ku me ditur sa të madh, ndërsa humbjet teknike krahasuar me vitin 2013 janë vetëm 0.48% ndërkohë që ato komerciale për 1.56%, pra gjithësej i kemi afër 2%, i cili me gjasë ka qenë pjesë e marrëveshjes së privatizimit të shpërndarjes dhe furnizimit. Çështja tjetër z.Ymeri tha se ashtu siç është raportuar këtu te faturimi dhe arkëtimi te faqja 52 e raportit te referenca 6.5 nuk tregohet se nëse inkasimi ka të bëjë vetëm me faturimin e vitit 2014 apo ka të bëjë edhe me inkasimin e mjetëve të vitit 2013, 2012 e kështu me radhë, se nëse kjo është atëherë duhet të bëhet një ndarje në atë përqindjen (%) ose raportin që po e konsiderojmë si përparim në raportin në mes inkasimit apo faturimit, pra kjo është dashur të figurojë në raport në mënyrë të ndarë. Për sa i përket tarifave këtu e kam një çështje ku kisha pasur nevojë me shpjeguar se përmenden dy shqyrtime të tarifave që kanë ndodhur vitin e kaluar i zakonshmi dhe i jashtëzakonshmi, pastaj në fund të gushtit apo në fillim të shtatorit dhe të jashtëzakonshmin thuhet sipas vendimit të bordit të ZRRE-së përkundër dy kërkesave që kanë qenë edhe nga KEK-u edhe nga KEDS-i për rritje të tarifës për shkak të ngjarjes të Termocentralit “Kosova A”, është pranuar vetëm e KEDS-it, ndërkohë që për sa i përket kërkesës së KEK-ut thoni që e keni lënë ta shqyrtoni kur keni raport zyrtar të hetimit të përfunduar për atë se çfarë ka ndodhur në Termocentralin “Kosova A”, dhe si rrjedhojë i kemi 2 lëvizje: njërën anë KEDS-it i mundësohet që të mbledhë më shumë, d.m.th. të hyra në maksimum të lejuara që reflektohen në tarifë, që janë për 12.4 milionë euro të rritura të krahasuar me shqyrtimin e 8, nëse nuk gaboje që i bie i rregullti ndërkohë që po ashtu bëhet një shqyrtim i të hyrave maksimale për KEK-un të cilët i zvogëlohet për 12 milionë euro duke pasur parasysh energjinë të cilet nuk do ta prodhojë. rrjedhimisht nuk do ta shesë si pasojë e avarisë së Termocentralit Kosova A. Në këtë drejtim sqaroi z.Ymeri i bie që diku dallimi është 24.4 milionë krahasuar me shqyrtimin e tarifave, ndërkohë që kuantifikohet importi i rritur i lejes apo i rritjes së importit kur ajo vlersohet në para thoni që do të jetë më e larta 18.25 milionë ose 75 milionë euro, nëse nuk gaboje. Në faqën 63 të raportit, pra thuhet që është lejuar rritja e importit nga 450 sa ka qenë 450.3 Giga-vat në 762.7 Giga-vat kjo e para ka qenë dashur të kushtoj 27.01 milionë euro, ndërkohë që e dyta do të kushtoj 45.76 milionë euro, pra dallimi këtu është 18.25 milionë euro, ndërkohë që dallimi në të hyrat që do t'i mundësohen tani me rritjen dhe mospagimin për KEK-un janë 24 milionë euro, pra kemi një dallim prej 5.75 milionëve euro të cilin kam nevojë me ma shpjeguar pse, dhe ku shkojnë ato para, pyeti z. Ymeri. Çështja tjetër ka të bëjë me ngarkesat për kapacitetet e energjisë, prodhimin të energjisë elektrike për KEK, pra kostoja kapitale prej 25.4 milionë euro thuani në Raport të realizuar në vitin 2014 paraqesin normën 40% të kostove të kapitalit të lejuar nga ZRRE, pyetja ime tha z.Ymeri është se a do ti

përshtaten këto tarifa për investime të kapitalit të pëinvestuar d.m.th. për ato që janë lejuar dhe të cilat paheqitur të mos realizuar, e njëjta vlen pastaj edhe për operatorin e shpërndarjes 17.9 milionë euro të realizuara për vitin 2014 paraqesin normen 85% të kostove të kapitalit të lejuar, pra a do të ketë përshtatje edhe për të? Edhe çështja tjetër ai tha se është ajo se kurrë nuk është shpjeguar ky 17.9 milionë euro, a është paguar apo si ka rezultuar? Edhe në Raport nuk shihet që e keni marrë në konsiderat edhe një padi që KEK-u ia ka bërë nëse nuk gaboj ZRRE-së në të njëjtën kohë 19 milionë euro të cilat ata kanë supozuar që edhe që kanë qenë të lejuara, si të hyra nuk kanë arritur t'i realizojnë dhe rrjedhimisht në këtë rast nëse këto të dyja janë të vërteta i bie që KEK-u, si kompani publike ka qenë e dëmtuar për 36 milionë euro, pra 17.9 milion euro që ia ka dhënë KEDS-it dhe 19 milion euro që nuk ka mundur me i realizuar. Edhe çështja e fundit ka të bëjë me Termocentralin "Kosova A", mendoj dhe kam pritur që në Raportin e vitit 2014 të ZRRE-së do ta kemi një kapitull të veçantë i cili shpjegohet për atë sa keni informata se çfarë ndodhi në Termocentralin "Kosova A", më 6 qershor të vitit 2014, pra e dini se ka qenë moment i ndjeshëm politik, me qenë se ka qenë dita e fundit e fushatës zgjedhore, ka qenë jashtëzakonisht moment i ndjeshëm edhe humanitar, sepse kanë humbur jetë njerëzish edhe këtë duhet të na shpjegojë dikush se çfarë ka ndodhur dhe si? Ai shtoi se e di se KEK-u e ka bërë një rast apo hetim preliminar dhe një raport preliminar për këtë, mirëpo në këtë drejtim KEK-u u ankua se nuk ka mundur ta bëjë hetimin e mirëfilltë duke pasur parasysh që organet hetuese të Kosovës i kanë marrë informatat bazë, paralogun e regjistrimeve dhe hardisqëve të kompjuterave në mënyrë që ta kenë të qartë saktësisht se çfarë ka ndodhur dhe si ka ndodhur, këtu ka disa mundësi, pra prej deshtimeve profesionale dhe politike deri te dështimet teknike që mund të kenë ndodhur qoftë nga menaxhmenti apo dikush tjetër. Mirëpo ZRRE-ja duhet ta raportojë këtë gjë dhe mendoj se është obligim i ZRRE-së në mënyrë që të jetë më aktive në kërkesat karrshi organëve hetuese që të hetohet ky rast. Është e pakuptueshme se si pas gjithë këtyre muajve në ende nuk e kemi një raport zyrtar të asaj se çfarë ndodhi në Termocentralin "Kosova A" dhe të kemi emrat e përgjegjësve për humbjen e jetëve të këtyre dy njerëzve dhe për shkaktimin e këtyre humbjeve që po i ndodhin sistemit të energjisë në Kosovë, tha në fund z.Ymeri.

**Blerim Grainca-** Tha se do të flasë për 4 grupe apo fushat e interesit. E para lidhet me operacionet ditore të Zyres Rregullatorit të Energjisë që lidhet me stafin dhe buxhetin, sikurse e dini, siç e kemi parë nga raporti zyra ka një shkurtim të buxhetit nga viti paraprak dhe kërkoj të dijë se a ka ndikuar kjo në vetë performancën e stafit dhe performancën e zyrës edhe për kundër faktit se po ashtu janë dhënë edhe një numër i madh i rekomandimeve të caktuara nga auditori për vitin paraprak, a janë përfshirë këto vërejtje dhe sygjerime që ka dhënë auditori në vitin vijues d.m.th. a janë marrë parasysh? Fusha tjetër për të cilën u interesua z. Grainca puna që lidhet me rregullimin e tregut, kryesisht të sektorit të tarifave, me theks të veçantë të tarifave nxitëse për arsye se sikurse që e dini me vendimin e Këshillit të ministrave të komunitetit të energjisë Kosovës i është caktuar si obligim edhe për gjitha vendet që pretendojnë për anëtarësim janë të obliguar të prodhojnë 25 % të energjisë nga burimet e ripërtitshme, a mendoni se këto tarifa nxitëse janë interesante për investitorët? Ai shprehu mendimin se këto nuk ndikojnë kur tarifave momentalisht nuk ndikojnë në rritjen e objektivave që ka vendi ynë dhe nuk stimulojnë investimet e huaja. A mendoni dhe a keni bërë rekomandime për ndryshimin e këtyre tarifave, qoftë Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, qoftë të Kuvendit? Fusha e tretë është ajo që lidhet me konsumatorët, shtoi z.Grainca, duke thënë se kemi ngritur shqetësime edhe më herët se ka një numër të madh të ankesave në bazë të hulumtimeve dhe atyre që kemi rreth 7 mijë ankesave që janë momentalisht dhe 40 % prej të cilave nuk kanë marrë akoma përgjigje, ankesat janë të ndryshme, duke filluar nga pakënaqesitë që lidhen me tarifën, pastaj faturat jo reale, dyshohet për fryrje të faturave, mos lexim i faturave, faturim paushall nga ana e operatorit dhe po ashtu faturat të cilat kanë të bëjnë me vitet e kaluara, vetëm përsëriten të njëjtat fatura. Çështja e katërt lidhet me aksidentin që ndodhi së fundi, mungesa e një raporti më detaj jo nga zyra juaj, por nga organet hetuese që do të ndikonte në gjetjen e faktorëve të cilët kanë ndikuar me çështjet operacionale, fatkeqësitë natyrore apo lidhur me çështjet menaxheriale dhe a do të ndikonte kjo

në performance e konsumatorëve që do të ndikonte në marrjen e licencave të ardhshme, nëse ka pasur një operim jo kualitativ që ka shkaktuar edhe dëme në njerëz, pyeti në fund z. Grainca.

**Duda Balje** parashtroj disa pyeti: A ka problem ZRRE-ja më pakon e ligjeve që rregullojnë këtë fushe dhe a mendoni që duhet të ketë edhe ndonjë ligj tjetër për të ndihmuara në punën e ZRRE-së? Si po shkon procesi i ankesave të konsumatorëve dhe sa është efikase ZRRE-ja në zgjedhjen e këtyre ankesave, pasi që në raport po theksohet se është një numri i madhe e këtyre ankesave? Për Termocentralin “Kosova A” që është pa licencë, cilat janë pasojat negative në mungesë të licencës?

**Besim Beqaj** - Tha se raporti është një përshkrim i krejt atyre aktiviteteve që janë bërë gjatë vitit 2014. Në raport janë 2-3 gjëra të rëndësishme dhe nuk do të hyjë në çështje teknike, as të çështjet e buxhetit, se asnjëra e as tjetra nuk besoj që na përkasin neve drejtpërdrejt, por njëkohësisht janë çështje që kanë nevojë të trajtohen, nga ana jonë në mënyrë ma të fokusuar ma të thellë, nëse kemi nevojë sepse kjo është çështje që as nuk mundemi ta kuptojmë për një orë diskutim me juve, as nuk pretendoj që e kuptojmë brenda kësaj periudhe të caktuar. Ai tha se është me rëndësi shumë që ta kuptojmë se çka ka ndodhur në raportin e KEK-ut. Ai potencoi se kjo është pika themelore të cilën ne duhet që ta kuptojmë saktë çka po ndodh edhe do të ishte mirë që t’ia shpjegoni Komisionit, por edhe opinionit të gjerë edhe shoqërisë civile, lidhur me atë raportin me 19.3 milionë në mes të KEK-ut dhe KEDS-it dhe ta kuptojmë se a i kanë marrë ato mjete KEK-u më herët nga konsumatorët apo nuk i kanë marrë? A janë këto mjete të cilat janë avulluar diku apo çfarë ka ndodhur? Do të ishte mirë anëtarët e komisionit dhe çdo qytetar ta di saktësisht se çka ka ndodhur. Duke ditur se KEDS-i, respektivisht KEK-u janë të dytë që i nënshtrohet rregullatorit dhe duhet t’ju bëhet me dije të gjithë qytetarëve se në rast se KEDS-i nuk përformon konform licences së tij, e drejta është e juaja, e zyrës së rregullatorit që të ia merrni licencën dhe të merrni asetet pa kompenzim konform kontratës të cilën i është bërë, tha z. Beqaj. Ai më tutje tha se duhet të ia shpjegoni mirë qytetarëve se ky transaksion kur është bërë si i tillë çështja e 110-shëve, pra të linjave 110-she për dallim nga vendet e tjera të rajonit janë pjesë e transisionit, jo të KEDS-it dhe që nuk është në rastet e tjera në vendet në rajon, pra këto gjëra kisha dashur që t’i dimë dhe ta kuptojmë më mirë. Për tarifën nxitëse ai u shpreh se tarifën nxitëse janë shumë motive çështja është afati i kohës, mirëpo tarifën nxitëse ju e dini që në shumicën e vendeve të rajonit, por edhe më gjerë tash ka tendenca të eliminimit të tarifave nxitëse, jo tarifën nxitëse si të tilla, por besoj që problemi është më shumë te investimet e huaja, nuk janë tarifën por është procedura e marrjes së licencës, e cila duhet që herë të shkon te rregullatori, herë të shkon te komuna. Bile këtu konsideroj që është një penges serioze, sepse në shumicën e rastëve kena rezervim të licencave për një periudhë të caktuar dhe nuk bëhet me një veprim konkret. Do të kisha dashur të dijmë, tha z. Beqaj, për përbërjen e tarifave, si formulohen tarifën, qytetarët, por edhe në se faturat që ne i marrim të energjisë realisht është e vështirë që ta kuptojmë se çka hyn krejt në këtë process dhe si faturohen ato. Në fund ai kërkoi informata për licencën, për Termocentralin Kosova A, dhe koston e mos vazhdimit në rast se kjo ndodh, sepse ne po flasim gjithmonë me pompozitet kur flasim për energjin alternative, por do duhet ta dijnë qytetarët edhe ne, si komision, edhe Kuvendi sa është kostoja e energjisë alternative në rast se shkojmë me procedura shumë ma të shpejta dhe sa kishte me pasur mundësi konsumatori për ta përballuar atë energji e cila do të përdorej nga burimet alternative, nëse shkojmë me hapa ma të përshpejtuar? Duke iu drejtuar përfaqësuesve të ZRRE-së tha se ju e dini që Ministra e Zhvillimit Ekonomik e bënë një plan të energjive të ripërtitshme konform standardëve të Bashkimit Evropian, ne e kemi planin 20-20 të cilin pretendojmë me e bërë, por aty ju e dini që ka dallimi në mes asaj çka është ujore dhe çka është energji tjetër alternative, tha z. Beqaj.

**Raif Qela** - Tha se çështjet kryesor të këtij raporti, mungesat e tij i shtruan parafolsit edhe mendoj që i shtruan kërkesat kryesore, prandaj mendoj se është më se e nevojshme që të jepën përgjigje në këto. Ai pyeti se cili është raporti ndërmjet çmimit të energjisë elektrike në Kosovë

dhe në në rajon, sepse publikut i intereson kjo çështje në kohën se ka ankesa për rritjen e energjisë elektrike.

**Znj. Merita Kostari** përfaqësuese e ZRRE-së - Tha se kisha me i ndarë pyetjet në mes nesh për arsye se kemi ekspertizën tonë secili në lemi të ndryshme. Prandaj unë do të përgjegjigjëm në pyetjet që kanë të bëjnë me strukturën ligjore dhe me çështjet ligjore në përgjithësi. Bordi në bazë të ligjit të Zyrës së rregullatorit të energjisë elektrike ka obligim me monitoruar edhe me menaxhu Zyrën e rregullatorit të energjisë, departamentet kanë aktivitetet e tyre edhe në bazë të propozimeve të tyre. Të gjitha që janë të përshkrume në këtë raport në fund vinë te bordi, licencimet, tarifat, aktivitetet të gjitha veprimet që i bëjnë departamentet, në fund vinë te bordi, sqaroi znj.Kostari. Lidhur me Kosova A ajo tha se raporti zyrtar i organëve të hetuesisë ende nuk ka arritur te ne, nuk ka arritur dhe neve e kemi kërkuar atë raport shumë herë edhe prej KEK-ut edhe prej organëve të hetuesis. Ne, si ZRRE, bordi, edhe stafi e kemi viztuar dy herë Kosovën A, edhe vetë kemi bërë në kuadër të raportit një vizitë monitoruse, mirëpo përgjegjjet që kemi marrë ne, si zyrë e rregullatorit, njësoj si publiku, përgjegjja është e njëjtë që organet e hetuesis ende nuk e kanë kryerë punën e tyre. Objekti është i mbyllur kjo është e fundit dhe përshkaqe të sigurisë qysh na kanë shpjeguar tash ende nuk ka filluar hetuesia të punojë brenda. Sa i përket kësaj, kjo as për ne nuk mjafton si përgjigje për arsye se dy veta kanë humbur jetë, pastaj kjo ka ndikuar në tërë sistemin jo vetëm në të hyrat e KEK-ut, por edhe në importet të panevojshme edhe ka ndodhur në momentin kur ne vetem sa e kemi kryer një pjesë të vlersimit të të hyrave, për gjenerimin e patëm kryer në atë kohë. Sa i përket kësaj ajo tha se pas shume bisedimeve edhe vizitave që kemi bërë, janë dy raporte: raporti i KEK-ut dhe raporti jozyrtar i një grupi ekspertëve, por organet e hetuesisë nuk na kanë dhënë fjalën e tyre, në momentin kur kjo tash ndërlihet edhe me aplikacion për tarifa, në momentin kur kemi vlersuar të hyrat të përgjithshme të sektorit, ne në momentin kur e kemi kryer me vlersimet të të hyrave në vlersimin e rregulltë mbas kësaj ka ardhur kërkesa e KEK-ut, pastaj edhe të KEDS-it për rritje të të hyrave përshkak të ngjarjes të jashtëzakonshme. Kjo në bazë të aspektit ligjor deri sa nuk kemi raportin e hetuesis se çka ka ndodhur dhe a ka qenë faktori njerzor në pyetje apo vismajor, ne nuk kemi mund me vlersuar dhe me i rritur tarifat për atë kërkesë të KEK-ut dhe e vetmja gjë që kemi mund me bërë në ato moment që me e siguruar furnizimin për konsumatorët ka qenë rritja për një vlerë të importit dhe ZRRE ka vepruar në këtë mënyrë. Për këtë çështje do të shpjegojë kolegu nga departamenti i tarifave do të shpjegojë në detaje. Rasti gjyqësor 19 milionë dhe 17.9 milion euro ajo është një rast gjyqësor, jo dy. Ajo është një që KEK-u e trajton si 19 milionë euro, ndërsa ne e trajtojm si 17 milionë euro, ankesa e KEK-ut është në gjykatë dhe rasti ende nuk ka filluar séancë gjyqësore nuk u mbajt ende, KEK-u i ka paguar paraprakisht prapëseprapë kjo është çështje tarifore. Më tutje duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve znj. Kostari tha se ligjet nuk janë problematike, sa i përket punës tonë, nuk kemi problem sa i përket ligjeve. Për kërkesa të konsumatorëve në bazë të rregullës tonë konsumatorët njëherë ankohen për çdo rast të pakënaqësisë, ankohen në KEDS ose KESKO. Kompania ka obligim ligjor që brenda afatit 2 muaj me e kthye përgjegjjen pozitive, ose negative në ankesën e konsumatorit, nëse brenda 2 muajve kompania nuk e kthen përgjegjjen nuk e trajton çështjen çdo konsumator ka të drejtë të orientohet te Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Në bazë të rregullave për zgjedhjen e kontestëve që është rregulla jonë aplikohet edhe në KEK edhe në KEDS edhe në të gjitha kompanit e rregulluara. Ne kemi departamentin për mbrojtjen e konsumatorëve, ka dy muaj për me e kthye përgjegjjen me vendos në mënyrë pozitive ose negative të kërkesës së konsumatorit, nëse konsumatori nuk është i kënaqur atëherë ai ka të drejtë me u orientuar te bordi i rregullatorit të energjisë që është shkalla e dytë në kuadër të zyrës së rregullatorit të energjisë, edhe bordi ka 2 muaj afat, nëse pala përsëri nuk është e kënaqur atëherë ka të drejtë me inicuar rast gjyqësor

**Krenar Bujupi, përfaqësues i ZRRE-së** sqaroi se ZRRE në këtë rast i përfaqëson konsumatorët e vendit d.m.th. kontesti është në mes të KEDS-it dhe konsumatorëve të vendit për pagesa se sa duhet të paguajë tarifa të energjisë, vetëm kjo duhet që të jetë e qartë. Ne që jemi në kontest

gjyqësor është e vërtetë, por në rast se kontesti gjyqësor shkon në anën e KEK-ut atëherë do të jenë konsumatorët ata të cilët e paguajnë këtë kontest, këtë çështje. Çështja e kësaj është se sipas mendimit tonë, po flas vetëm për mendimin e ZRRE-së se është gjykata dhe nuk dua që të paragjykoj çështjen e gjykatës. Mirëpo sipas vendimit të ZRRE-së, KEK-u gjatë vitit 2012 ka mbledhur të hyra më shumë se sa që i kemi lejuar se çdo vitë i bëjmë shqyrtimet e rregullta e cila na ka thënë neve si ZRRE se KEK-u ka tepriçë diku rreth 17.9 milionë kontesti pse KEK-u e përmend 19 milionë sepse janë rregullat se si përcaktohen. Mirëpo as KEK-u nuk e ka kontestuar këtë pjesën e vlerës së mbetur prej 2 milionë se kjo ka ndodhur tani se KEK-u u dashtë me paguar investitorin e ri i cili e ka marrë kompanin pa asnjë detyrim sipas kontratës që e ka pasur, 19 milionshi janë para të mbledhura nga KEK-u të cilat nuk janë përdorur në sistemin, si të tilla ne, si ZRRE, kemi thënë që ato para duhet të kthehen në sistem. Kontesti vazhdon, mirëpo duhet të ketë të qartë se nuk ka të bëjë me KEDS-in aq shumë sa që ka të bëjë me konsumatorët. I vetmi send që është i lidhur me KEDS-in ka qenë për shkak të privatizimit dhe për shkak se privatizimi është kryer pa detyrime dhe normalisht kostot e sistemit atë vit kanë kushtur 242 milionë euro, ndërsa KEDS-it apo KEK-ut në atë kohë, po edhe KEDS-i që ka vazhduar ja kemi mbledhur prej konsumatorëve vetëm 224 milionë euro, që do të thotë që pjesa e mbetur duhet me u paguar prej dikujt, e ai dikushi ka qenë KEK-u, sepse ka pasur licencën e furnizimit publik më herët, d.m.th. i ka mbledhur ato para dhe tash duhet me i paguar ato para, kjo është pak a shumë sa i përket kontestit që është duke u vazhduar kontesti. Nuk ka ndodhur ndonjë zgjidhje e këtij kontesti ende dhe besojmë që ne, si ZRRE, ky kontest do të zgjidhet në të mirën e konsumatorëve që do të thotë për ZRRE-në. Të gjitha vështirësitë që i kemi pasur gjatë këtyre viteve në sistemin energjetik bordi përballet me to, vështirësitë më të mëdha që kemi pasur që jemi përballur që është shumë vështirësi e madhe është siguria e furnizimit edhe për atë po ndodhin projekte të reja të “Kosovës së Re” edhe për atë po mundohemi edhe për licencimin e burimeve të ripërtrishme. Mirëpo duhet të theksohet shumë qartë se Kosovës i nevojitet një siguri e furnizimit shumë ma e madhe se që e ka tani. Kur folëm për fleksibilitet vështirësitë normalisht kanë të bëjnë shumë vështirësi të tjera, kanë të bëjnë edhe me humbjet e mëdha që i kemi në sistem energjetik, po ashtu vështirësi më të mëdha që i kemi, sepse asetet e sistemit tonë energjetik në Kosovë, po janë të vjetërsuara dhe dalëngadalë duhet të ndërrohet. Këto të gjitha kanë me qenë barrë pak ma e madhe e konsumatorëve të vendit. Një prej vështirësive që jemi duke punuar shumë ka qenë edhe ndarja e sektorit në mes të atyre se cila pjesë duhet të mbetet të rregulluara dhe cila pjesë duhet të vazhdojë të parregulluara më tutje. Tash për tash, për fat të keq, të gjitha janë të rregulluara për shkak të nivelit të vogël të konkurrencës në treg, mirëpo pjesët që duhet të jenë të liberalizuara duhet të jenë gjenerimi dhe duhet të jetë furnizimi. Investimet ka ngecje pak nga aprovimet e lejuara duhet të kuptohen se si bëhen investimet. Ne i kemi përcaktuar investimet gjatë periudhës 5 vjeçare të tarifave d.m.th. kur kemi marrë vendim të vitit 2012 kemi përcaktuar nivelin e investimeve dhe planin e investimeve që duhet të bëhen nga të gjithë të licencuarit, ka pasur ngecje pak te investimet. Mirëpo kjo duhet të zgjidhet përmes procesit që është rishqyrtimi apo riprogramimi, bazës së asetëve të rregulluara ku përfshihen të gjitha asetet e sistemit energjetik. Kemi bërë edhe njëloj inspektimi me atë se sa janë realizu investimet apo jo. Të kuptojmë se procesi tarifar 5 vjeçar ka të bëjë edhe me investimet, ka të bëjë edhe me penalizime, ne i lejojmë për 5 vitet e ardhshme, mirpo vjen një kohë që investimet nuk bëhet siç duhet dhe rregullatori vendos që ta bëjë riprogramimin e këtyre investimeve. Nëse ka pasur prej 5 vjeçares tarifat i kemi rregulluar në aso mënyrë 5 vjeçare që të gjitha investimet që të cilat i kanë planifikuar kanë hyrë në tarifa dhe paguhet në tarifa nëse ato investime nuk bëhen operatorëve ekonomik i mirren paratë për ato investime që janë bërë dhe tarifave. Mirëpo i mirret edhe interesi i cili i ka marrë ato para dhe që i ka mbajtur gjatë atij viti p.sh. nëse kanë investuar në vitin 2013 ato para do të kthehen kurdo që të bëhet riprogramimi i aseteve. Për këtë vit e kemi problemin më të madh, e kemi pasur te KEK-u sepse ka pasur një mungesë të investimeve që ka pasur me u bërë në miniera dhe aty e kemi një hapsirë më të madhe, e kemi diku rreth 30 milionë euro investime ngecje të cilat nuk janë bërë nga KEK-u, nga KEDS-i i kemi dikun rreth 3 milionë euro investime që nuk janë bërë për vitin 2014 ndërsa nga KOST-i i kemi, varet se për



shkak që kanë bërë avanse, për shkak të linjes së re dhe nëse avanset i konsiderojmë që kanë me u përmbushur atëherë të gjitha këto investime kanë me u përmbushur se 30 milionë euro investime ka pasur për këtë vit, të cilat duhet të përmbushën, po gjatë këtij viti kanë pasur vetëm avanse të cilat janë dhënë, mirëpo investimet ende nuk janë plotësuar. Kur numërohet të 3-jat gjithsej bëjnë diku rreth 70 milionë euro. Humbjet teknike dhe komerciale e përmendem që ka trend pozitiv, mirëpo duhet të theksohet se humbjet teknike dhe komerciale rregullohen nga bordi, pavarësisht kësaj që po shihet këtu humbjet teknike dhe komerciale janë të lejuara në tarifa janë të lejuara në një vlerë më të vogël, tash jemi diku KEDS-i është duke paguar 4% humbje totale më shumë se sa që e lejojmë ne, d.m.th. po i bartin ata gjatë këtij viti i kanë bartin rreth 6 milionë euro që duhet të paguhet vetëm edhe pse ka humbje ata duhet të paguajnë, ata kanë një humbje prej 6 milionëve euro për shkak të mos zvogëlimit të humbjeve, d.m.th. ne e quajmë të performances së tyre. Arkëtimi është trend pozitiv, mirëpo prapë duhet të kuptohet se ne e kemi të vendosur me rregullore në 5% do me thënë duhet me u mbledhur gjithsesi 95% , d.m.th. është borxh i keq vetëm 5 %, nëse arrijmë më poshtë atëherë ata paguajnë nëse arrijnë më lart atëherë e kanë si insertiv. Shumica e humbjeve komerciale duhet theksuar se ne i shikojmë në tërësi, mirëpo me ju qasur më shumë problematikave, humbjet në veri janë diku rreth 4-5 % të gjithë totalit të humbjeve. Këto janë të pafaturuara d.m.th. se ne nuk e gjejmë në momentin se kur e gjejmë kur janë faturuar nuk është problem me arkëtuar, problem është që nuk mund me gjetur, me faturuar edhe të tjerët kabli ilegal që nuk e dimë kush po e merr atë energji, është thjesht vjedhje e energjisë.

**Besim Beqaj,** Tha se ma konkretisht humbjet teknike janë përshkak të mos realizimit të investimeve që janë barrë e drejtpërdrejt e investorëve, ndërsa humbjet komerciale është dallimi në mes të asaj se ku çohet rryma dhe sa faturohet, ndërsa pjesa që faturohet këta i mbledhin 95 % dhe është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e KEDS-it në këtë rast për me mbledhur, në rast se nuk i mbledh ai i pagun vetë. Nuk e kemi rastin sikurse në Shqipëri, se në Shqipëri kanë marrë për obligim që edhe në rast se ata nuk i mbledhin shteti ia kompenson, ndërsa pjesën tjetër humbjet që nuk i kanë të regjistruara janë vjedhjet nëpër kablla të ndryshme dhe për këtë arsye është kërkuar atëherë që të kemi edhe lexim digjital të qëndrave ku nuk bëhet vetëm ora, por për regjistrimi degjital prej një trafostacioni e deri te orët me e pa ku janë humbjet dhe mbi këtë bazë pastaj mund të adresohet më shumë për këtë ka qenë kërkesë që ne e kemi bërë atëherë me qenë më të saktë.

**Krenar Bujupi,** për çështjet e orëve kisha dëshiruar që të flasim pak më shumë. Cilësia e matjes nuk i takon Zyrës së Rregullatorit, është me kompetenca të Ministrisë, Tregtisë dhe Industrisë apo më saktësisht agjencis të meteorologjisë. Normalisht, por gjithmonë duhet të kuptohet në sistemin energjetik ne presim që të gjitha orët që hyjnë janë plotësisht të licencuara dhe të bllobuara dhe janë të matura edhe si të duhet. Kemi marrë informata për këtë problem dhe është çështja ende duke u diskutuar në mes Ministrisë të Tregtisë dhe Industrisë si dhe operatorit të furnizimit të cilët në këtë rast është KEDS-i. Në rregulla për çështjen e shqyrtimit tarifar të jashtëzakonshme ishte pyetje nga deputeti Ymeri, duhet dy gjëra t'i ndajmë d.m.th. e kemi të gjitha rregullat për përcaktimin e tarifave janë të ndara për çdo të licencë, gjeneratori e ka ndryshe, KEDS-i pak më ndryshe, KOSST-i pak më ndryshe. Në këtë rast kur flitet për shqyrtime të jashtëzakonshme një prej pikave kryesore të shqyrtimit të jashtëzakonshëm është dhe mbetet se a kanë qenë apo jo nën kontrollin e të licencuarit që ka ndodhur kjo ngjarje e jashtëzakonshme. Për këtë arsye KEK-u, për shkak se në KEK ka shkaktuar aksidenti. Ne ende kemi, e dijmë, a ka qenë nën kontroll të tyre apo jo, dhe për atë gjë nuk ka mundur për me u dhënë kurrfarë shqyrtimi KEK-ut përshkak se nuk u plotësua ajo pika kryesore. Importi 12.5 milionë euro kjo ka qenë pak si shpjegim për me u treguar se çfarë është diferenca në mes të asaj të lejuar, 5% ka qenë pragu, ne kemi lejuar vetëm 5.18 %, normalisht këto diferenca siç po i shihni në eksport-import çdo gjë në tarifa është i komplikun dhe nuk mund të paraqitet shumë lehtë në raport. Për “Kosovën e Re” ju them më shumë informata, mirëpo tash për tash fatkeqësisht kemi mbetur te

pjesa e ofertës financiare, e cila është hapur dhe është shqyrtuar nga komuniteti, këshilltarët e transaksionet, e të tjerë.

**Rifat Blakaj përfaqësues i ZRRE-së,** çështja e fleksibilitetit te ne është me të vërtetë çështje e dorës së parë, ne kemi pasur kapacitete të mjaftushme të instalime një pjesë e tyre nuk janë operative përveç asaj kishim me mjaftuar sikurse të gjitha këto njësi të mund të operonin me kapacitetet që i kanë në dispozicion. Mirëpo duke e pasur parasysh se “Kosova A”, është shumë e vjetër, fleksibiliteti i saj është zvogëluar pothuajse në minimum. “Kosova B” ka në mundësi të fleksibilitetit, “Kosova e Re” presim që të ketë një mundësi pak më të madhe të fleksibilitetit nuk do ta mbulojnë komplet, por do ta përmirsojnë situatën.

**Blerim Grainca** te burimet e ripërtitshme është në interes të dimë për të, sepse vërejtjet e mia nuk kishte të bënte vetëm me çmimet për burimet e ripërtitshme, por edhe afatin kohor, por ideja është të ikja e investitorëve d.m.th. nëse licencat jepen te burimet e ripërtitshme për 10 vjet apo për 12 vjet, mendoj që nuk është e mjaftushme për kthim të kapitalit, sepse këto janë investime afatgjate, vendet e rajonit i kanë edhe më të gjata 15- 20, a është aprovuar kjo çështje?

**Krenar Bujupi:** A janë të mjaftushme? Sipas rregullatorit për neve kemi marrë informata nga investitorët se nuk janë të mjaftueshme! Prandaj kemi kërkuar edhe nga konsulenca ndërkombëtare. Kur i kemi parasysh që të gjitha caqet gati janë arritur të gjitha burimet e ripërtitshme, caqet që kanë pasur për autorizime, atëherë besojmë që janë të mjaftushme, me i përmendur me emra autorizimet finale që janë përfundimtare për ndërtim hidrocentrale i kemi 4 apo 38 mega vat, nga era e kemi 1 që është 1.35 mega vat dhe solare e kemi pasur 1 që e kemi pasur vetëm 100 kilovat. Autorizime preliminare që duhet të presim 1 vit deri sa të shëndrrojnë në autorizim final i kemi 13 hidrocentrale prej 151 mega vatëve, i kemi 5 me erë, prej 145 mega vatëve, 4 solare prej 9.06 mega vatëve gjithsej janë 307 mega vat që janë në process të aplikimit, ndërsa ato që janë në proces të autorizimit preliminare që janë, që ende nuk janë bërë dhe janë diku rreth 11 aplikacione që në total arrijnë në vlerë prej 84.94 mega vat.

**Kryetari,** Kam një kërkesë që Kuvendit duhet me ja dërguar raportin që e kupton gjithkush, jo vetëm ata që janë inxhinierë apo specialistë, d.m.th. tjera herë raportet që nuk janë të qarta nuk do të aprovohen, secili deputet duhet me pa strukturën e të ardhurave të lejuara, nuk duhet me u bërë inxhier me e kuptuar ato formula, gjithçka mundet me u shpreh më thjesht.

*Pas debatit, Komisioni vendosi që të nxjerrë Konkluzionet dhe Rekomandimin në një nga mbledhjet e radhës.*

#### **4. Të ndryshme.**

**Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa,** i njoftoi anëtarët e Komisionit se nga Qeveria është propozuar Lista e kandidatëve për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, dhe tani kjo listë e kandidateve është sjellë në Kuvend dhe propozoi që mbledhja e radhës të mbahet më 08.04.2015, në ora 13:00.

*Me propozimin u pajtuan anëtarët e Komisionit.*

**Mbledhja përfundoi në orën 10:30.**

#### **E përgatiti:**

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

**Kryetar i Komisionit,**

-----  
**Muhamet Mustafa**